

« Gjeniu i ngjan çdokujt, e atij askush – Onore De BALZAK



art&kulturë

Intervistë e skulptorit të mirënjohur Destan Gashi

Mjeshtri besnik i simfonive të grurit

Nuk mendoj se veprat e mia do të mbesin gjithmonë në mërgim. Ato janë të përhapura gjithandej, dhe nëse mbesin jashtë, me vete mbajnë emrin tim – Destan Shqiptari! Mbetem me shpresë se së shpejti do të na ofrohet mundësia që veprat tona t'i ekspozojmë edhe në Kosovë. Kjo intervistë do të më bëjë të mendoj edhe më shumë në këtë drejtim

Intervistoi: Ajete ZOGAJ

“Iliria Post”: Cilat janë përparësitë dhe vështirësitë e një artisti si ju, që jeton larg atdheut, në Vjenë, të cilën ju e quani “motra e Parisit”?

GASHI: Mund të them që atdheu më mungon, por më duhet të theksoj, gjithashtu, se këtu ku jam ka kushte më të mira për punë. Edhe tregu është më i madh, niveli kulturor, gjithashtu, e gjëra të ngjashme. Sigurisht që do të ndihesha më mirë, sikur kushtet që gëzoj këtu, t'i kisha edhe në Kosovë. Shpresoj shumë që nuk do të jetë e largët koha, kur edhe unë do të kem mundësi të krijoj në vendlindjen time.

“Iliria Post”: Çka e mban një artist si ju të lidhur me atdheun? A është kjo e vështirë për krijuesin apo nxitëse për krijimtari artistike?

GASHI: Lidhjet me atdheun janë të shumanshme. Në radhë të parë, lidhja me njerëzit e mi, të afërmit; pastaj me krijuesit e të tjerë. Një lidhje të veçantë kam pasur me të ndjerin Agim Çavdarbasha. Prej tij kam marrë shumë frymëzime. Përveç kësaj, të qenët larg atdheut më motivon, ose më frymëzon në krijimtari. Kur bëj një skulpturë, zakonisht kam përpara fytyrat e njohura nga vendi im.

Gjithmonë ëndërroj që veprat e mia t'i ekspozoj në Prishtinë


“Iliria Post”: Cfarë lidhesh mbani me vendlindjen? Po me Prishtinën dhe me artin që krijohet e që ekspozohet këtu, sa keni mundësi dhe interesim që të jeni në këto rrjedha?

GASHI: Më duhet ta pranoj se këto lidhje nuk janë aq të kënaqshme. Por për këtë, siç e dini edhe ju, ka shumë arsye. Gjendja e vështirë në Kosovë nuk ofronte shumë mundësi për komunikim nga jashtë me atdheun. Pengesat kanë qenë gjithmonë të natyrës politike.

Sikur të doja, për shembull, të hapja një ekspozitë, ku do të duhej të merja leje!

Nejse, kjo gjendje është përmirësuar pas 1999-s, por ende ka vështirësi. Nuk duhet të harroni që te ne, në Kosovë, u desh të niste gjithçka nga fillimi.

Gjithmonë e kam në mendje, madje një ëndërr, që veprat e mia të mund t'i ekspozoj edhe në Prishtinë e qytete të tjera të Kosovës. Por, veprat e mia janë bukur të mëdha, të rënda dhe kërkojnë transport të veçantë. Nuk është një punë e lehtë, por nuk është as një punë që nuk bëhet. Siç e thashë pak më parë, kam pasur lidhje shumë të mira me të ndjerin Çavdarbasha. Kur ai hapte ekspozitë, kam qenë gjithmonë me të. Tani mbaj lidhje me skulptorin Aziz Islamaj, profesorin e nderuar të Akademisë së Arteve. Kam lidhje të mira edhe me piktorët Refki Gallapeni dhe Ruzhdi Hoxha. Kosova ka njerëz të mrekullueshëm, talente të shkëlqyera edhe në fushën e skul-



Skulptori i shquar Destan Gashi

pturës dhe pikturës. Por, kushtet e vështira ekonomike nuk u ofrojnë këtyre njerëzve hapësira të mjaftueshme, ku ata do të mund ta manifestonin talentin e tyre. Jam i vetëdijshëm për kushtet e vështira, në të cilat ndodhet madje edhe Fakulteti i Arteve në Prishtinë, por besojmë se do të bëhet gjithmonë e më mirë.

“Iliria Post”: Në artin e veprës suaj a mund të thoni çka ka nga fryma e vendlindjes, Kosovës, dhe çka nga dijet që keni marrë gjatë studimeve në Bruksel, Belgjikë?

GASHI: Nganjëherë mendoj me vete, pse kjo ide, ose pse ajo tjetra! Shumë nga veprat e mia, madje më të bukurat, paraqesin një femër, që mund të jetë, për shembull nëna a motra ime. Sigurisht që këto frymëzime vijnë nga lidhjet me ngrohtësinë e prindërve, një lidhje që lind që nga fëmijëria dhe zhvillohet tërë jetën. Një pjesë tjetër e skulpturave të mia paraqesin meshkujt. Këtu gjithmonë kam si frymëzim një burrë shqiptar, për shembull, një rugovas, i cili shkëlqen edhe kur kalon nëpër vështirësi. Në Belgjikë kam studiuar dhe kam pasur fatin të njihem me njerëz të mëdhenj të artit, si për shembull me Andrei Eiberg, një skulptor shumë i njohur belg. Por, pas përfundimit të studimeve, më 1986

kalova në Vjenë. Janë bërë shumë vjet që jam larguar nga andej, por ende mbaj kontakte me ish-profesorët e mi, me kolegë të tjerë nga fusha e artit. Në Vjenë jetoj me bashkëshorten dhe me djalin tim Gurin. Bashkëshortja ime, Barbara, me të cilën kam pasur fatin të njihem gjatë studimeve në Belgjikë, është piktoresh. Unë merrem me skulpturë, ajo me pikturë, dhe zakonisht ekspozitat i bëjmë së bashku. Me një fjalë, ne e ndihmojmë njëri-tjetrin, nganjëherë edhe duke dhënë frymëzime për vepra të caktuara, qoftë në skulpturë, qoftë në pikturë. Të dy jemi anëtarë të Shoqatës së Artistëve dhe Shkrimtarëve të Pavarur të Austrisë. Kjo anëtarësi na ndihmon shumë, jo vetëm me ide, por edhe me mjete konkrete, siç është, për shembull përgatitja dhe organizimi i ekspozitave të rregullta nëpër vende të ndryshme të Austrisë. Mund të them se organizimi është në nivel shumë të kënaqshëm.

Nuk mendoj se veprat e mia do të mbesin gjithmonë në mërgim

“Iliria Post”: A mund të thoni për lexuesit e gazetës sonë, cili është niveli i arteve pamore në Austri, qoftë në bazë të kritikës së arteve pamore, qoftë në bazë të bindjes suaj dhe kriterit profesional?

GASHI: Niveli i arteve pamore në Austri është goxha i lartë, ndër të parët në Evropë. Nëse më lejohet të bëj një kritikë, ka vepra që janë krijuar në të kaluarën, e të cilat janë aq të bukura, madje të përkryera... Nga ana tjetër, ka periudha kur artistët përjetojnë kohë krizash; fillojnë të kërkojnë diçka të re. Keni parasysh të ashtuquajturin “art modern”. Kam pasur rastin të shoh në vitet fundit krijimin e shumë veprave “moderne”, që lindën nëpër vende apo sheshe të ndryshme të Vjenës. Disa ishin vepra metali, ndonjë rrotë, ndonjë vegël a figura abstrakte. Nuk kaloi shumë kohë dhe veprat e “artit modern” u tërhoqën. Sigurisht që ato nuk kishin tërhequr sa duhet kureshtjen e kalimtarëve. Unë punoj vetëm me gurë, domethënë skulpturë guri. Veprat prej metali nuk më kanë tërhequr kurrë dhe nuk mendoj se kanë perspektivë.

“Iliria Post”: A mund të flisni për ndonjë idhull tuajin në fushën e artit? Cilin nga artistët botërorë që ka punuar skulpturë në gur e çmoni më së shumti?

GASHI: Për mua, skulptori më i madh është August Rodeni. Veprat e tij janë thjesht të përkryera, ato flasin shumë për lidhjet njerëzore. Sa herë i shoh, më duket sikur më flasin; janë thjesht vepra që komunikojnë me shikuesin.

“Iliria Post”: Po nga artistët shqiptarë?

GASHI: Ka shumë skulptorë të talentuar shqiptarë. Unë kam ndjekur me shumë vëmendje veprat e skulptorit të ndjerë Çavdarbasha. Jam impresionuar edhe me veprat e shkëlqyera të skulptorëve shqiptarë si Hektor Dule, Kristaq Rama, Muntaz Dhrami. Por, mbi të gjithë, mendoj, artisti i madh shqiptar për mua mbetet Odhise Paskali. Veprat e tij, mendoj se janë të një niveli shumë të lartë artistik, dhe ato janë vlerësuar lart jo vetëm nga shqiptarët, por edhe në arenën ndërkombëtare.

“Iliria Post”: A mund të na tregoni çka dhe çfarë stili krijohet aktualisht në Austri?

GASHI: Aktualisht në Austri po dominon stili abstrakt. Ka një thënie që thotë se, hekurin e drejtë lëre të drejtë, ndërsa të shtrembëtin drejtoje. Këtu është duke ndodhur e kundërta: të drejtin e shtrembërojnë, ndërsa të shtrembëtin e lënë ashtu siç është – të shtrembër. Me një fjalë, është duke dominuar stili abstrakt, që mua më duket i pakuptueshëm. Ja po ju jap një shembull të këtij arti, që për mua nuk është art. Njëri mund t'i marrë 30

Ragip SYLAJ

GURI GURTË NË ËNDRRA

(Letër skulptorit Destan Gashi në Vjenë)

Ka kohë pa të shkruar...

Harrova të të pyes mos të janë lodhur daltat
A po iu dhem gurëve kur po lindin figura të gjalla
Mos i bëj konkurrencë Zotit se të hidhërohen engjëjt

Dashuria për gurin ta bëri Gurin gur të çmueshëm
Apo dashuria e gurit të futi në robërinë e hyjneshave

Guri a flet gurisht, hyjnisht, shqip a gjermanisht
Apo në gjuhë zotrash në gjuhë arti në gjuhë kozmosi

Thuaju se Guri nuk humb në peshë kur ka peshë
Thuaju se Guri flet se Guri s'hesht edhe kur hesht

Thuaju atyre që s'shohin se Guri është fjalë e valë
Është Hyj, është monument dhe qenie e gjallë

Se ne jemi fëmijët e tij se ne jemi fryma e tij
Se ai është forca jonë, hija jonë e gjallë

Mjerë ai që s'flet me gurin t'ia dijë dhimbjen dashurisë
T'ia dijë mëshirën e t'ia marrë bekimin

Për të mbetur mjeshtër guri këngëtar guri
Valë e gurtë në luadhe të blerta

Gur i gurtë në ëndrra
Ëndërr e gjallë e gurit që flet

Harrova të të pyes, maestro
Mos janë harxhuar shikimet e atyre që s'e shohin bukurinë
Bukurinë hyjnore në zemër Guri

Edhe një gjë desha ta di:
Guri i Shqipëria është vëlla me Gurin e Evropës?

Prishtinë, 25 korrik '06

biçikleta, t'i saldojë njërin mbi tjetrën, dhe ja një vepër “e madhe”! Fatkeqësisht, ky stil është duke dominuar aktualisht. Unë mbetem besnik te skulptura në gur, te veglat e mia gdhendëse, dalta dhe çekani.

“Iliria Post”: A mendoni se do të mund të hapni një ekspozitë me veprat tuaja në Kosovë apo në Shqipëri, apo mos veprat tuaja do ta mbajnë në vetvete statusin e mërgimtarit të përjetshëm, duke qenë vepra të një autori nga Kosova?

GASHI: Sigurisht që unë dhe bashkëshortja ime, Barbara, jemi shumë të interesuar që veprat tona t'i ekspozojmë edhe para publikut shqiptar. Por, siç e thashë edhe më herët, një ndër pengesat kryesore është transporti. Kini parasysh faktin që një skulpturë e imja mund të peshojë deri në tre tonë. Transporti ka qenë deri më tash pengesa kryesore, që nuk kam mundur t'i ekspozoj veprat e mia në Shqipëri, prej nga kam pasur shumë oferta. Nuk mendoj se veprat e mia do të mbesin gjithmonë në mërgim. Ato janë të përhapura gjithandej, dhe nëse mbesin jashtë, me vete mbajnë emrin tim – Destan Shqiptari! Mbetem me shpresë se së shpejti do të na ofrohet mundësia që veprat tona t'i ekspozojmë edhe në Kosovë. Kjo intervistë do të më bëjë të mendoj edhe më shumë në këtë drejtim.